




Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë është entitet juridik i pavarur me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditorë për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM), duke ndarë riskun kreditor me institucionet financiare.

## RRITJA E KREDITIMIT PËR NMVM-TË NË KOSOVË

Përmes garantimit të portofolit kreditor të institucioneve financiare, ne synojmë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë, mbështetjen e prodhimit vendor dhe të atyre shërbimeve të cilat krijojnë vlerë të shtuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.

### Kreditë e miratuara



## DRITARJA AGRO


Kapitali për Dritaren Agro është nga KfW

Deri më tani:

28.2 milion euro kredi të lëshuara nga IPF-të

13.6 milion euro të garantuara nga FKGK


Të shpërndarë në 812 Agro Kredi.



## SHPËRNDARJA SEKTORIALE


Shpërndarja e portofolit të FKGK-së nëpër sektorë të ndryshëm pasqyron ekonominë e vendit.

### KREDITË SIPAS SEKTOREVE



## KRIJIMI I VENDEVE TË PUNËS

Krijimi i vendeve të reja të punës është një nga objektivat kryesore të themelimit të FKGK-së. 10,743 kredi për NMVM-të parashikojnë 17,579 vende të reja pune



## KREDITË PËR GRATË NË BIZNES


Mundësi më të mira për sektorët dhe për kategoritë më pak të shërbyera ekonomike dhe të popullsisë, duke përfshirë gratë, është një objektivi tjetër i rëndësishëm për FKGK-në.

Nga 10,743 kredi për NMVM-të, 12.5 % janë lëshuar për gra pronare/bashkëpronare në biznes.



## RRITJA E QARKULLIMIT

Deri më 31 mars 2022 10,743 kredi për NMVM-të parashohin 529.4 milion euro rritje të qarkullimit mbi bazën e tanishme të qarkullimit të NMVM-ve përkatëse.



## BASHKËPUNËTORËT E FKGK-SË

FKGK-ja bashkëpunon me institucionet financiare (bankat, IMF-të, IJF-të), me donatorët, me Qeverinë e Kosovës, me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me Komunitetin e NMVM-ve.

DONATORËT	BASHKËPUNËTORËT	INSTITUCIONET FINANCIARE TË REGJISTRUARA
Qeveria e Kosovës Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID Banka Zhvillimore Gjermane -KfW	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – SIDA Banka Botërore Fondi Investues Evropian - EIF (Programi COSME) Banka Evropiane për Investime Korporata Sfidat e Mileniumit/Fondacioni Mileniumi i Kosovës	Banka Ekonomike Banka Kombëtare Tregtare Banka për Biznes NLB Banka ProCredit Bank Raiffeisen Bank TEB Raiffeisen Leasing Kosovë FINCA KEP KRRK AFK

Arritjet e Fondit deri më datë 31 Mars 2022

